



## Lajme

Postuar më 19/07/2023

**SHPLLJE E VENDIT VAKANT DHE THIRRJE PËR PARAQITJEN E SHPREHJES SË INTERESIT PËR ANËTAR TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE ANËTARËT TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NGA RADHËT E ANËTARËVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE**



**K**uvendi i Shqipërisë, bazuar në nenin 55, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, shpall vendin vakant për 1 anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e anëtarëve të organizatave të shoqërisë civile.

Njoftohen anëtarët e organizatave të shoqërisë civile që janë të interesuar të kandidojnë për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 54, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, që brenda datës 5 gusht 2023, të shprehin interesin e tyre përmes një kërkesë me shkrim drejtuar Avokatit të Popullit.

Sipas përcaktimeve të nenit 54 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet si më poshtë:

- a) të jenë shtetas shqiptarë;
- b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të kenë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;
- c) të kenë të paktën 15 vite përvojë pune në profesion si jurist;
- d) të kenë një profil të spikatur shoqëror, integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut;
- e) në kohën e kandidimit, të jenë të punësuar ose të angazhuar për të paktën 5 vjet, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme pa ndërprerje, në një organizatë të shoqërisë civile për fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut;
- f) në kohën e kandidimit, të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit për të paktën 2 vjet, me përjashtim të atyre të angazhuar në organizata ose klinika që ofrojnë ndihmën ligjore falas ose për funksion të organizatës;
- g) të mos jenë kandidatë të propozuar nga avokatia ose trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë;

h) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

i) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike, gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit;

j) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

k) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve të inteligjencës;

l) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin, të paktën, dokumentet e mëposhtme:

a) jetëshkrimin e përditësuar;

b) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;

c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

d) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

e) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;

f) çdo dokument tjetër që vërteton përmbushjen e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 54, pika 2, të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Shprehja e interesit dhe dokumentet

shoqëruese duhet të dërgohen në adresën elektronike ap@avokatipopullit.gov.al, si dhe në adresën postare të

Avokatit të Popullit:

Blv. “Zhan D’Ark”, Nr. 2, Tiranë

**SHPLLJE E VENDIT VAKANT DHE THIRRJE PËR PARAQITJEN E SHPREHJES SË INTERESIT PËR ANËTAR TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NGA RADHËT E ANËTARËVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE**

Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në nenin 153, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, shpall vendin vakant për 1 anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e anëtarëve të organizatave të shoqërisë civile.

Njoftohen anëtarët e organizatave të shoqërisë civile që janë të interesuar të kandidojnë për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 152, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, që brenda datës 5 gusht 2023, të shprehin interesin e tyre përmes një kërkesë me shkrim drejtuar Avokatit të Popullit.

Sipas përcaktimeve të nenit 152 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet si më poshtë:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të kenë marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;

- c) të kenë të paktën 15 vite përvojë pune në profesion si jurist;
- d) të kenë një profil të spikatur shoqëror, integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut;
- e) në kohën e kandidimit të jenë të punësuar ose të angazhuar për të paktën 5 vjet, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme pa ndërprerje, në një organizatë të shoqërisë civile për fusha të lidhura me sistemin e drejtësisë ose të drejtat e njeriut;
- f) në kohën e kandidimit të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit për të paktën 2 vjet, me përjashtim të atyre të angazhuar në organizata ose klinika që ofrojnë ndihmën ligjore falas për funksion të organizatës;
- g) të mos jenë kandidatë të propozuar nga avokatia ose trupa e pedagogëve të drejtësisë;
- h) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- i) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike, gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit;
- j) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të shërbimeve të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- k) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve të inteligjencës;
- l) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar.

Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin, të paktën, dokumentet e mëposhtme:

- a. jetëshkrimin e përditësuar;
- b. një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;
- c. formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- d. një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- e. një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;
- f. çdo dokument tjetër që vërteton përmbushjen e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 152, pika 2, të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Shprehja e interesit dhe dokumentet shoqëruese duhet të dërgohen në adresën elektronike [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al), si dhe në adresën postare të Avokatit të Popullit:

Blv. “Zhan D’Ark”, Nr. 2, Tiranë

## Bashkelidhur



**Formular Deklarimi  
Konflikt Interesi anëtar  
KLP nga shoqëria  
civile.docx**



**Deklaratë për  
mbështetje të  
shoqërisë civile për  
KLP.docx**



**Formular Deklarimi  
Konflikt Interesi anëtar  
KLGJ nga shoqeria  
civile.docx**



**Deklaratë për  
mbështetje të  
shoqërisë civile për  
KLGJ.docx**



**Formular  
Dekriminalizimi.doc**



**Formular AIDSSH.doc**



**VENDIM NR 2 -  
19.07.2023.PDF**

## Lajmet e fundit

Komisioni për  
Çështjet Ligjore,  
Administratën  
Publike dhe të  
Drejtat e Njeriut  
zhvilloi seancë  
dëgjimore për  
Raportin Vjetor  
të veprimtarisë

Kryetarja e  
Kuvendit, znj.  
Lindita Nikolla,  
mori pjesë në  
tryezën e  
diskutimit "Kodi  
i Sjelljes,  
Transparenca  
dhe

Kuvendi u  
mbledh në  
seancë plenare,  
miratoi një  
projektrezolutë,  
shtatë  
projektligje dhe  
dy